

Interpretimi i besimit

**Përceptimi i përfaqësimit dhe
pjesëmarrjes**



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Interpretimi i besimit

**Përceptimi i përfaqësimit dhe
pjesëmarrjes**

Prishtinë, shtator 2013

Të drejtat autoriale © 2013. Instituti Demokraci për zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citate të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikës dhe shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem arkivimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo çfarëdo mjete elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Studimi është përgatitur nga:

Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi

Me kontribut nga:

Ideal Hoxha dhe Rezarta Delibashzade

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit për reformë zgjedhore, “Hedhja e votës, jo votim i hedhjes: Për përfaqësim të vërtetë në Kosovë“, me financim të Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës (FDFA). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Demokracisë për zhvillim (D4D).

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive, 4

Hyrje, 5

Metodologjia e anketës dhe aspektet demografike, 6

Demografia, 6

Feja, 8

Burimi i informatave, 9

Madhësia e familjes, 10

Fushat shqetësuese, 11

Identiteti, 13

I. Përfaqësimi, 15

A e pasqyron parlamenti shoqërinë tonë?, 15

Anëtarësimi, 18

Partitë politike, 21

II. Pjesëmarrja, 24

Lista e votuesve, 24

Pjesëmarrja në zgjedhje, 25

Ndikimi, 27

Kontakti me përfaqësuesit, 30

III. Besimi në zgjedhje, 35

Rëndësia e votimit, 35

Zgjedhje fer, 37

Besimi në rezultate, 39

Shkeljet, 41

IV. Sistemi zgjedhor dhe sjellja votuese, 45

Partia apo kandidatë individualë?, 45

Përzgjedhja votuese, 48

Përzgjedhja e partisë, 52

Efektii i fushatës, 58

Përzgjedhja e kandidatit dhe koha e votimit, 61

V. Pritjet e lidershipit, 64

Çfarë liderësh dëshirojnë kosovarët në përgjithësi?, 64

Çfarë mendojnë kosovarët për liderët aktualë?, 66

Konkluzë, 74

Lista e publikimeve, 76

Seria: Zgjedhjet, 78

Përmbledhje ekzekutive

Gjersa po zvarritemi ngadalë drejt demokracisë, duhet reflektuar nëse jemi duke lëvizur në rrugën dhe ritmin e duhur. Kemi zhvilluar një anketë për këtë qëllim e cila mund të bëhet mjet i rregullt për vlerësim dhe riparim të udhëtimit tonë drejt republikës përfaqësuese. Rezultatet e anketës nuk janë inkurajuese por ato përbëjnë një bazë për krahasime të ardhshme.

Shumica e kosovarëve nuk e shohin parlamentin si pasqyrë të shoqërisë. Shumica e respondentëve mendojnë se nuk janë të përfaqësuar dhe kanë vendosur të mos votojnë. Përveç votimit, kosovarët nuk kanë mendim të lartë për anëtarësi në grupe qytetare. Përveç anëtarësisë në grupe fetare, të gjitha llojet tjera të anëtarësive kanë rënë, që është shenjë e një deficiti të konsiderueshëm demokratik dhe mjedisi të pjekur për shprehje agresive të pjesëmarrjes publike.

Zyrtarët e zgjedhur kryesisht takohen me ithtarë të partisë. Votuesit e papërcaktuar kanë prirje të vendosin për kë të votojnë vetëm në Ditën së Zgjedhjeve, indikacion ky i një shkalle të lartë të votuesve të zemëruar. Votuesit kanë shfaqur mbështetje të fuqishme për lista të hapura dhe një shkallë të lartë të parapëlqimit për kandidatë sesa parti.

Përgjigjet sfidojnë mitin se skena politike e Kosovës është statike që shumë shpesh dekurajon partitë e reja. Vetëm gjysma e votuesve kanë votuar njëjtë nga 2007 deri 2010, që vërteton se skena nuk është stabile siç është menduar. Një e pesta ka votuar ndryshe dhe të tjerët kanë abstenuar.

Është inkurajues fakti që gjersa familjet bëhen gjithnjë më të vogla dhe më të arsimuara, kosovarët bëhen gjithnjë e më alergjikë ndaj shkeljeve dhe ndryshojnë kujt i japin votën. Grupet opozitare janë më pak antagonistë sesa mosvotuesit, por as kosovarët më të pafuqishëm nuk e kanë humbur besimin në fuqinë e votës.

Hyrje

Kosova qeveriset nga një demokraci përfaqësuese dhe marrëdhënia e qytetarëve me përfaqësuesit e tyre është vetë thelbi i demokracisë. Gjersa shumica prej nesh preokupohemi me çështje tona të përditshme, është shqetësuese nëse personat të cilëve u kemi besuar paratë publike nuk i mbrojnë interesat tona. Prandaj këtë punim e kemi titulluar “Përkthimi i besimit”, gjë që jemi munduar të masim.

Shteti i ri i Kosovës shpeshherë krahasohet me një foshnje të re, por kjo mbi të gjitha vlen për përpjekjet e saj për demokratizim. Tranzicioni ka qenë i mangët e me pengesa të shumta. Kujdesi për demokracinë e sapolindur të Kosovës vërtetë duhet të jetë i njëjtë me atë të një foshnje të sapolindur. Ky përkujdes nënkupton nevojën për një analizë të thellë të progresit të saj dhe për t’i shtruar disa pyetje të vështira. Rruga përpara është e mundur vetëm nëse bëjmë një vlerësim të sinqertë të gjendjes aktuale që është pikënisja jonë.

Synimi ynë nuk ishte vetëm të fitojmë një pasqyrë të gjendjes aktuale, por edhe t’i shohim trendet. Në përpjekjet tona për t’i kuptuar dinamikat e sjelljes zgjedhore, shumica e pyetjeve që kishin të bënin me demokracinë janë ndërthurur me aspekte të ndryshme demografike.

Pjesa e parë përshkruan metodologjinë bashkë me disa shënime demografike. Substanca e dokumentit është organizuar në pesë kapituj (i) përfaqësimi, (ii) pjesëmarrja, (iii) besimi në zgjedhje, (iv) sistemi zgjedhor dhe sjellja e votuesve, dhe (v) pritjet nga lidershipi.

Metodologjia e anketës dhe aspektet demografike

Kjo anketë është kryer me 952 respondentë dhe verifikimi personal është bërë me 176 respondentë. Pak më shumë se gjysma e respondentëve ishin meshkuj (486 meshkuj që përbënin 50.5%), gjersa 466 (49.5%) ishin femra. Mostrat ishin të rastësishme dhe pasqyronin grupmoshat, nivelet e të ardhurave dhe arsimimin. Të dhënat janë vlerësuar para përdorimit të tyre për analizën tonë. Puna në terren dhe përpunimi i të dhënave është kryer nga organizatat hulumtuese Index Kosova, BBSS Gallup International.

Anketa është përfaqësuese e popullatës madhore (18+), siç është saktësuar në kornizën e mostrës. Përjashtime përfshijnë njerëzit në spitale, burgje, objekte ushtarake e të ngjashme. Meqë nuk ka të dhëna të regjistrimit të popullsisë për Kosovën, ndarja e popullatës sipas komunave është bazuar në votuesit e regjistruar në komuna. Metoda e anketimit është intervista sy më sy, letër dhe laps, në shtëpi të respondentëve, me marrje të mostrave me probabilitet të rastësishëm në disa faza. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë. Margjina e gabimit për mostrën në nivel vendi: $\pm 2.5\%$ me 95% nivel të besimit.

Demografia


Para se të hyjmë në analizën e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes, ekzistojnë një numër çështjesh demografike që duhet theksuar. D4D beson së është praktikisht e pamundur që të arrihet përparim në demokracinë e saj nëse Kosova nuk bëhet shoqëri më e barabartë, e cila fuqizon gratë dhe ushqen diversitetin. Në këtë kuptim, është me rëndësi të kuptohen ndarjet e ndryshme shoqërore dhe ndikimin e tyre në qeverisje.

Një nga treguesit kryesorë të zhvillimit shoqëror është

zhvillimi gjinor dhe niveli që gratë të mbyllin hendekun me burrat. Kosova do ta ketë të vështirë ta zhvillojë dhe konsolidojë demokracinë e saj për aq kohë sa gratë nuk përparojnë në shoqëri dhe nuk arrijnë ta përmirësojnë mirëqenien e tyre. Edhe përfaqësimi edhe pjesëmarrja janë mjete për arritjen e zhvillimit të barabartë dhe shërbehen nga rritja e barazisë. Një nga faktorët që anketa ka hulumtuar është profesioni i individëve. Gati dy të tretat e femrave kosovare janë amvise, ndërsa vetëm 10% prej tyre janë në marrëdhënie pune. Kjo sfidë strukturore jo vetëm që pengon zhvillimin por edhe demokratizimin.

	Gjinia e respondentit		
	Mash.	Fem.	Gjithsej
Në punë?	48.7%	10.3%	29.1%
Amvise?		58.4%	29.8%
Student apo praktikant?	15.0%	13.6%	14.3%
I pensionuar/me aftësi të kufizuar?	10.7%	4.1%	7.4%
I papunë dhe në kërkim të punës?	21.2%	10.3%	15.7%
I papunë, por jo në kërkim të punës?	4.3%	3.3%	3.8%

Arsimimi (sipas gjinisë)



Një indikator i rëndomtë me të cilin i kemi analizuar krahasuar rezultatet ishte niveli i shkollimit. Ekziston një hendek i konsiderueshëm gjinor në arritjet arsimore që gjithashtu zvogëlon aftësinë e gruas për të ushtruar ndikim në politikëbërje. Gratë përbëjnë gati 80% të kosovarëve pa arsimim formal dhe vetëm një të katërtën e të diplomuarve universitarë.

Përveç gjinisë dhe arsimimit, rezultatet e paraqitura në këtë punim janë krahasuar edhe sipas moshës, madhësisë së familjes, të ardhurave, si dhe tipareve më pak të rëndomta siç janë praktimi i fesë, burimet e informatave.

Feja

Rreth 40% të kosovarëve asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në shërbime fetare, gjersa rreth 35% marrin pjesë në shërbime fetare së paku një herë në muaj. Gratë nuk janë më pak fetare, por e praktikojnë fenë më rrallë. Përqindja e kosovarëve që praktikojnë fenë disa herë në vit korrespondon me numrin e kosovarëve që e konsiderojnë veten “të moderuar”. Numri i kosovarëve që kurrë nuk e praktikojnë fenë është afro 40% (përqindje shumë më e lartë tek gratë), që korrespondon me pjesën e kosovarëve që e konsiderojnë veten si “liberalë”.

Vijueshmëria fetare (sipas gjinisë)



Një pjesë e vogël e kosovarëve e konsiderojnë veten jobesimtarë (1%) gjersa një përqindje e ngjashme konsiderohen fundamentalistë.


Burimi i informatave

Një parakusht i rëndësishëm për një demokraci funksionale është të ketë burime të shumta të informimit. Shumica e kosovarëve kanë theksuar se mbështeten në gazetatat,

Kanalet televizive për informim për problemet aktuale	
RTK	41.3%
RTV21	23.4%
KTV	22.4%
Klan Kosova	7.9%
Të tjera	2.7%
Asnjë/Nuk e di/Refuzoj	2.7%

ndonëse duke pasur parasysh tirazhin e gazetave në vend, kjo vështirë të jetë e vërtetë. Duket se për t'u informuar, viset urbane dhe në veçanti Prishtina gjithnjë e më pak mbështeten në gazeta e gjithnjë e më shumë në internet dhe televizion. Nga kanalet e ndryshme televizive, rezultatet e anketës sugjerojnë se mbi 41% mbështeten në RTK për informata. RTK nuk zotëron vëmendjen e shikuesve femra, të cilat në masë më të madhe e përcjellin RTV 21.

Segmentim i qartë i moshës



Ekziston edhe një segmentim i qartë i tregut përka h grupmoshat. RTK gëzon vëmendjen e të moshuarve gjersa Klan Kosova synon më shumë të rinjtë. KTV anon drejt shikuesve të moshës së mesme gjersa RTV 21 drejt shikuesve femra të të gjitha grupmoshave (30% të shikueshmërisë së femrave krahasuar me 16% të burrave).

Madhësia e familjes

Një nga faktorët demografikë që e kemi analizuar është edhe madhësia e familjes. Mostra ishte përfaqësuese dhe pasqyron kosovarët që jetojnë në jetojnë në familje të vogla dhe mëdha njëlloj. Shumica e respondentëve jetojnë në familje prej 5 deri 6 anëtarësh, siç është vërejtur nga hulumtimi ynë.

Fushat më shqetësuese (sipas madhësisë së familjes)							
Anëtarët e familjes	1-2	3	4	5	6	7	> 8
Respondentët (%)	9%	9%	15%	19%	18%	12%	17%
Respondentët (no)	86	86	140	186	176	115	163
Arsimi	1.2%	2.3%	2.8%	7.0%	2.9%	0%	4.3%
Infrastruktura/rrugët		3.5%	1.4%	1.1%	1.7%	2.6%	6%
Energjia elektrike	1.2%	2.3%	5.7%	5.4%	4.0%	2.6%	7.4%
Mbeturinat	5.8%	3.5%	7%	1.6%	6.9%	1.7%	1.8%

Ekzistojnë disa shqetësime që janë specifike për familje të vogla dhe të mëdha. Shkollimi dhe energjia elektrike janë shqetësim më i madh për familjet e mëdha, sigurisht për shkak të kostove më të mëdha të shkollimit të më shumë fëmijëve. Infrastruktura dhe mbeturinat paraqesin vështirësi për familjet më të vogla që kryesisht jetojnë në vende urbane. Përgjithësisht, madhësia e familjes nuk doli të jetë faktor përcaktues, prandaj dhe kemi paraqitur shumë pak analiza krahasuese me këtë tregues.

Analiza krahasuese e rezultateve sipas të ardhurave ka nxjerrë rezultate mjaft interesante gjithashtu. Çështjet si

ekonomia, infrastruktura dhe energjia elektrike prekin kosovarët e çdo niveli të të ardhurave, gjersa të tjerat prekin disa grupe të të ardhurave ndryshe. Shëndetësia dhe shkollimi paraqiten si shqetësime të mëdha për të pasurit gjersa mjedisi është shqetësim për klasën e mesme. Papunësia është shqetësim madhor për të varfrit, të cilët janë po ashtu të shqetësuar me ujin e pijshëm dhe mbeturinat.

Fushat shqetësuese


Shqetësimet e njerëzve janë shumë të rëndësishme për t'u përcjellë meqë ato janë fushat rreth të cilave formohen prioritetet e tyre, dhe të cilat informojnë pritjet që liderët do të duhej t'i ofronin. Kosovarët janë mbi të gjitha të shqetësuar me zhvillimin ekonomik. Më shumë se një e treta e burrave (dhe gati një e treta e grave) besojnë se ekonomia është çështja më e rëndësishme. Kujdesi shëndetësor është shqetësimi i dytë me radhë, por më shumë për gratë (23%) sesa për burrat (13%). Uji i pijshëm, papunësia dhe arsimi paraqesin ndarje të ngjashme ndërmjet gjinive, gjersa energjia elektrike, mbeturinat dhe mjedisi janë shqetësime tjera të cilat preokupojnë kosovarët (shih faqen e radhës).

Nuk janë të gjitha shqetësimet të ndara njëllon ndërmjet të gjitha grupmoshave. Përkundër asaj që ekonomia është një nga problemet më shqetësuese për të gjithë kosovarët, të moshuarit janë të shqetësuar më pak se të rinjtë me këtë problem, trend ky i njëjtë edhe për arsimin. Në vend të kësaj, ata janë më të shqetësuar me shëndetësinë dhe rrugët. Më tutje në dokument ceket që të moshuarit shpeshherë kanë trende të ndryshme të votimit nga të rinjtë, dhe partitë që e kanë këtë grup si cak duhet të sigurojnë se shqetësimet e tyre inkorporohen dhe përfshihen në programet e tyre partiake si duhet.


Në anën tjetër, respondentët e rinj preokupohen më shumë

me çështjet me ndikim më afatgjatë, siç janë ekonomia, arsimi, dhe duket se ata me shkallë më të lartë të arsimit janë të shqetësuar për mjedisin dhe mbeturinat.

Fushat shqetesuese (sipas gjinise)




Shqetësimet e të moshuarve



Identiteti

Mënyra se si individët e identifikojnë veten është gjithashtu me rëndësi të madhe. Kosovarët për një kohë të gjatë e kanë vënë identitetin e tyre etnik në plan të parë, meqë ky ishte

Dy identitetet e para



aspekti më i rrezikuar për shqiptarët e Kosovës dhe ishte pikërisht patriotizmi etnik ai që mobilizoi rezistencën.

Identiteti është i paqëndrueshëm dhe duhet të përcjellet. Politikanët populistë do ta shfrytëzojnë çdo potencial të diskursit nacionalist, ndërsa politikanët pragmatikë do t'i përcjellin me kujdes mundësitë për ta kapur vëmendjen e qytetarëve me

vizion për zhvillim. Sa i përket identitetit parësor, mbi tri të

katërtat e respondentëve e kanë identifikuar veten si shqiptarë. Si identitet dytësor, gati gjysma e tyre u deklaruan si kosovarë, përderisa një e treta e si myslimanë.

Diskutimi i shkurtër për disa tipare demografike më lart hap rrugë për shtjellimin e pyetjeve që kanë të bëjnë me përfaqësimin, pjesëmarrjen, asocimin, procesin zgjedhor, sistemin zgjedhor, sjelljen votuese, si dhe pritjet e lidershipit, në pjesën vijuese të dokumentit.


I. Përfaqësimi

Kemi përzgjedhur një gamë të pyetjeve që masin përfaqësimin duke filluar nga shkalla në të cilën parlamenti pasqyron shoqërinë tonë, si dhe vlerësim se sa janë kosovarët anëtarë të grupeve të ndryshme me anëtarësi.

A e pasqyron parlamenti shoqërinë tonë?

Afeksioni i njerëzve për parlamentin dhe mënyra se si ai pasqyron shoqërinë tonë është tregues kryesor i evoluimit të demokracisë sonë. Është problematike që rreth 38% mendojnë se parlamenti nuk e pasqyron shoqërinë tonë. Përqindja e kosovarëve që mendojnë se parlamenti nuk përfaqëson shoqërinë është shumë më e lartë sesa ajo e atyre që e besojnë të kundërtën.

A e pasqyron Parlamenti shoqërinë tonë?




Gratë janë më pak kritike sesa burrat, meqë në përqindje më të ulët nuk pajtohen që parlamenti pasqyron shoqërinë. Sa i përket përceptimit për parlamentin, ndarja mes gjeneratave shpalos një nivel të lartë të tëhuajëzimit të rinisë. Kjo sugjeron një shkallë të konsiderueshme të mosinteresimit

në zgjedhje të rinisë dhe zemërimin masiv të grumbulluar në mesin e atyre që nuk janë në gjendje të përfitojnë nga klientelizmi.

Një trend i ngjashëm vlen për nivelin e shkollimit. Qytetarët me shkollim më të lartë (më shumë se 40% të respondentëve me shkollim të mesëm) e shohin parlamentin si më pak pasqyrues të shoqërisë.


Një analizë krahasuese sipas lidhjeve partiake zbulon se ithtarët e opozitës e shohin Kuvendin si më pak përfaqësues të shoqërisë. Ata që nuk votojnë kanë edhe më shumë dyshime dhe janë më antagonistë sesa opozita. Një situatë e ngjashme ekziston edhe me votuesit e papërcaktuar dhe me respondentët që janë përgjigjur me “refuzoj” apo “nuk e di”.

Parlamenti pasqyron shoqërinë tonë (sipas partisë)



Ata që kanë shprehur shkallën më të lartë të mosbesimit ndaj rezultateve, gjithashtu kanë shprehur dyshimin më të lartë për ndikimin e votave në vendimmarrje. Votuesit të cilët e kanë parë procesin zgjedhor si të padrejtë gjithashtu besojnë se parlamenti nuk pasqyron shoqërinë. Respondentët të cilët mendojnë se parlamenti është pasqyrë e shoqërisë kanë prirje të ndërrojnë votën e tyre më rrallë sesa ata që e mendojnë të kundërtën.

Parlamenti pasqyron shoqërinë (sipas të ardhurave)




Analiza krahasuese sipas të ardhurave zbulon një trend që është interesant por jo befasisht. Kosovarët super të pasur janë më së paku kritikë ndaj parlamentit, në pajtim me një studim tonin i cili argumenton se ka filluar të krijohet një klasë e pasur politike. Nuk është a pazakontë edhe në demokracitë më të zhvilluara që të pasurit janë në pozitë të rehatshme pavarësisht partisë në pushtet. Ky çështje nuk ka qenë pjesë e debatit të Kosovës dhe një shtresë e re shoqërore me lidhje të forta me politikën është krijuar. Qëndrimi më pak kritik i personave në pozitë më të mirë financiare është dëshmi shtesë e natyrës klienteliste të qeverisjes.

Ndryshe nga të pasurit të cilët zotërojnë financim të konsiderueshëm për të pasur ndikim në politikë, qytetarët e thjeshtë i kanë numrat nëse veprojnë bashkë. Shkalla në të cilën ata asocohen me bashkë-mendimtarët dhe se si organizohen bashkërisht për të nxjerrë një politikë të posaçme është test madhor për demokratizimin e mëtutjeshëm. Numri i klubeve të cilëve u përkasin kosovarët për ta mbrojtur interesin e tyre është tregues thelbësor i besimit në veprimin kolektiv.

Anëtarësimi

Anëtarësimi në organizata të ndryshme dhe avokimi përmes tyre është treguesi kryesor për të parë nëse e drejta e asocimit aplikohet në mënyrë efektive në praktikë. Kemi matur shkallën e anëtarësisë të kosovarëve në parti politike, afërsinë e tyre me to, si dhe anëtarësinë në grupe tjera jopartiake. Diagrami vijues përshkruan zbehjen e anëtarësisë në lloje të ndryshme të organizatave.

Asocim i lekundshëm




Anëtarësimi në parti kryeson mbi të gjitha llojet tjera të anëtarësisë, vijuar nga anëtarësia në sindikata të punës, grupe fetare, shoqëri civile, përderisa llojet tjera të anëtarësisë janë të papërfillshme. Vrojtimi kryesor është se anëtarësia është zbehur me kalimin e kohës. Përveç anëtarësisë në grupet fetare, të gjitha llojet tjera të

anëtarësisë kanë pësuar rënie. Lidhjet me grupet fetare janë veçanërisht të forta tek respondentët me shkollim të ulët.

Rënia është shumë shqetësuese meqë është pikërisht asocimi që mundëson pluralizmin e opinionëve në të cilat mbështetet demokracia. Në vijim tutje analizojmë disa prej arsyeve prapa kësaj rënie dhe në çfarë mënyre ndikon kjo në të ardhmen e demokracisë.


Më pak asocim për gratë



Në kontekstin tonë, duket se anëtarësia kryesisht varet nga gjinia. Burrat janë më shpesh anëtarë të pothuajse çdo lloji të grupeve me anëtarësi, përveç organizatave bamirëse. Për t'i parë arsyet prapa kësaj, është e nevojshme që të analizohen më tej rezultatet duke ekzaminuar shkaqet tjera të mundshme. Ndonëse në nivel të ulët edhe sipas standardeve kapitaliste, anëtarësia në sindikata të pavarura të punës ka pësuar rënie të mëtejme, dhe kjo vlen në veçanti për kosovarët me shkollim të ulët. Nga diagrami i mësipërm mund të nxirren dy mësim të rëndësishme. Anëtarësia në sindikata të pavarura është duke pësuar rënie nga i tërë spektri i arritjeve arsimore, por kjo rënie nuk ndodh në mënyrë të njëtrajtshme. Fuqia punëtore me shkollim më të lartë ka pasur një rënie të lehtë gjersa personat me shkollim më të ulët kanë pasur një rënie drastike, që po ashtu


pasqyron mungesën e industrisë prodhuese.

Anëtarësia në sindikata



Është interesante të theksohet se shkollimi është faktor i rëndësishëm shpjegues jo vetëm për sindikatat por edhe për të gjitha llojet e anëtarësisë. Anëtarësia në parti në përgjithësi ka pësuar rënie tek shumica e grupeve, por krahasuar me kalimin e kohës, ajo është rritur për respondentët me shkollim më të lartë.

Anëtarësia në parti politike




Anëtarësia në grupe tjera është po ashtu një tipar veçues për kosovarët e arsimuar. Anëtarësia në OJQ është pothuajse tërësisht tipar ekskluziv i kosovarëve që së paku janë regjistruar në universitet, por ajo ka pësuar rënie të konsiderueshme edhe për këtë grup.

Partitë politike

Sa i përket anëtarësimit në parti politike, tipari kryesor dallues është vendbanimi. Vetëm një në 20 kosovarë urbanë është anëtar i një partie, gjersa kosovarët ruralë janë 3-4 herë më të prirë të jenë anëtarë të partive. Standardi i ulët i jetesës dhe mungesa e mundësive për kosovarët ruralë mund të jenë arsye prapa interesimit të lartë për anëtarësi në parti – me shpresë të kushteve më të mira të jetesës dhe si mjet për të nxjerrë të mira dhe privilegje nga ajo.


Anëtarësia e partive politike



Përveç ndarjes së përgjithshme sipas vendbanimit, është me rëndësi të analizohet se çfarë afërsie ndjenjtë respondentët

me politikën dhe në cilat veçori demografike varet kjo. Analiza krahasuese sipas moshës nxorri atë që pritej, të rinjtë dhe të moshuarit janë më pak të lidhur me parti politike, për dallim nga personat në moshë të mesme të cilët janë të afërt me politikën. Diagrami në vijim ilustron dallimin gjinor, ku burrat ndjehen shumë më të lidhur me politikën sesa gratë.

Afërsia me Partitë Politike (sipas gjinisë)




Afërsia është natyrisht më e lartë për anëtarët (88%) gjersa më e ulët për ish anëtarët (65%) apo për ata që nuk kanë qenë kurrë anëtarë (60%). Ekziston një trend i moshës së partisë dhe afërsisë që respondentët ndjenin me partinë e tyre. Gati dy të tretat e ithtarëve të partive të etabluara mirë ndjehen të afërt me partinë, gjersa kjo shkallë ka pësuar rënie në 55-60% për partitë e reja, siç janë AKR dhe VV.

Votuesit që janë më të afërt me ndonjë parti gjithashtu besojnë më shumë se fuqia e votës mund të ndikojë në vendimmarrje. Ithtarët e afërt gjithashtu kanë prirje të votojnë njëjtë edhe për zgjedhje lokale edhe për ato qendrore nëse ato do të mbaheshin të njëjtën ditë. Ata gjithashtu kanë prirje të jenë votues stabil, prej të cilëve afro

70% janë përcaktuar se për cilën parti do të votojnë mjaft kohë para se të fillojë fushata, por është befasuese se një pjesë e konsiderueshme e tyre megjithatë do të vendosnin Ditën e Zgjedhjeve.

Afërsia e partinë (sipas partisë)



Viset rurale kanë shfaqur jo vetëm anëtarësi më të lartë në parti politike, por edhe në organizatat fetare dhe shoqatat rinore, gjersa banorët e qyteteve kanë prirje të jenë anëtarë në organizata të shoqërisë civile.


II. Pjesëmarrja

Shkalla në të cilën qytetarët marrin pjesë në çështje publike, që imponojnë vullnetin e tyre tek përfaqësuesit e tyre dhe gjejnë mënyra për të ndikuar në politikë është dallimi kryesor që dallon qeverisjen e mirë nga demokracia procedurale. Votimi është tipari kryesor i pjesëmarrjes, dhe ne kemi analizuar përvojat e njerëzve me votimin.

Lista e votuesve

Mospërfshirja në listë të votuesve është tregues kyç i përjashtimit të profileve të caktuara shoqërore. Respondentët që besojnë se nuk janë në listën e votuesve janë në margjina të skajshme të shoqërisë dhe nuk kanë mundësi që t'ju dëgjohet zëri i tyre në çfarëdo forme.

Emri nuk gjendet në listat e votuesve në qendër të votimit



Një në dyzet meshkuj nuk janë të përfshirë në listën e votuesve, gjersa shkalla e përfshirjes së grave dhe të rinjve është më e ulët. Kosovarët në gjendje më të mirë financiare gjithashtu kanë raportuar se nuk janë në listën e votuesve në një shkallë më të lartë se mesatarja. Anëtarët e partisë janë praktikisht gjithmonë në lista të votuesve, gjersa rreth 5% të votuesve që nuk janë anëtarë partiakë mungojnë nga listat e

votuesve. Gjithashtu, personat që nuk vendosin për kë të votojnë deri në ditën e zgjedhjeve kanë tendencë më të lartë që të mungojnë nga listat e votimit. Profilet më pak të përfshira në listën e votuesve gjithashtu janë më pak të përfshira në lloje tjera të pjesëmarrjes publike.

Nga votuesit të cilët kanë theksuar se emrat e tyre nuk janë gjendur në listat e votuesve, gjysma kanë votuar me kusht (që do të thotë se emrat e tyre ishin në vendvotimin e gabuar dhe nuk kanë munguar në tërësi), përderisa shumica kanë hequr dorë dhe në disa raste kanë votuar me letërnjoftime të tjerëve.

Pjesëmarrja në zgjedhje

Është me rëndësi që të shihen arsyet që kanë shtyrë njerëzit që të mos dalin të votojnë. Kategoria më e madhe ishin të rinjtë të cilit nuk kishin të drejtë vote për shkak të moshës së tyre (45%). Në dy studimet e mëhershme (trendet¹ dhe autidimi i listës së votuesve²) kemi theksuar se pjesëmarrja e raportuar në zgjedhje nuk del nga votimi i ulët por nga gabimet në listat e votuesve. Mesatarisht rreth 70-80% të banorëve të Kosovës dalin për të votuar, meqë shumica e personave që nuk votojnë janë emra të kosovarëve të cilët jetojnë në diasporë, në Serbi apo që kanë vdekur.


Kategoria e dytë më e madhe e mosvotuesve është e personave që nuk janë të interesuar në politikë (15%), ndjekur nga ata që nuk kanë votuar për arsye personale (10%). Kosovarët në gjendje më të mirë financiare kanë prirje të dalin të votojnë në përqindje më të madhe sesa bashkëvendësit e tyre më të varfër. Gratë kanë theksuar

¹ Instituti Demokraci për zhvillim. Shtator 2011. Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010. <http://d4d-ks.org/assets/2012/09/2011-09-22-Election-Deconstructing-Election-Trends-2000-2010.pdf>

² Leon Malazogu, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën. http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_3_ENG_WEB.pdf

arsye tjera personale për mosvotim gjersa burrat theksojnë se nuk kanë qenë në Kosovë gjatë asaj kohe apo nuk i kanë besuar rregullsisë së procesit gjedhor.

Mos votni për arsye se...



Ndikimi


Një tjetër çështje me rëndësi të madhe është perceptimi i aftësisë për të ndikuar në çështjet që preokupojnë rrethin e tyre. Të rinjtë ndjehen me më pak ndikim në çdo nivel, ku vetëm 1.8% për qind besojnë se kanë ndikim në çështjet e rëndësishme për vendin. Ata ndjehen të pafuqishëm edhe për sa i përket çështjeve që prekin familjet e tyre. Rreth 81-90% të respondentëve (varësisht nga grupmoshat) mendojnë se kurrë nuk kanë ndikim në çështjet shqetësuese për komunën e tyre.

Zëri im ka ndikim në çështjet që kanë të bëjnë me ...						
Grupmoshat	18-29	30-39	30-49	50-59	60-69	> 70
... familjen						
Gjithmonë	40,7%	60,3%	64,1%	69,4%	64,8%	61,1%
Disa herë	59,3%	39,2%	35,3%	29,7%	33,8%	37,0%
Kurrë		,4%	,7%	,9%	1,4%	1,9%
Lagjen/fshatin						
Gjithmonë	5,2%	9,7%	11,8%	11,7%	9,7%	14,8%
Disa herë	34,9%	43,0%	40,8%	48,6%	54,2%	50,0%
Kurrë	55,7%	44,3%	43,4%	34,2%	34,7%	31,5%
Nuk e di	4,3%	3,0%	3,9%	5,4%	1,4%	3,7%
Komuna						
Gjithmonë	,9%	1,7%	2,6%	2,7%	2,8%	
Disa herë	6,7%	15,7%	12,5%	18,0%	11,3%	11,3%
Kurrë	89,6%	81,4%	82,2%	76,6%	81,7%	81,1%
Nuk e di	2,7%	1,3%	2,6%	2,7%	4,2%	7,5%
Vendi						
Gjithmonë	,6%	1,3%	1,3%	,0%		
Disa herë	1,8%	5,1%	3,9%	5,4%	4,3%	3,7%
Kurrë	94,8%	89,8%	90,1%	87,4%	92,9%	88,9%
Nuk e di	2,8%	3,8%	4,6%	7,2%	2,9%	7,4%

Gjinia paraqet një ndarje tjetër, ku burrat qartas kanë më shumë ndikim sesa gratë, posaçërisht në grupmoshat prej 40 deri 70 vjeç. Të moshuarit janë përgjithësisht më me

ndikim (pothuajse monopol total në viset rurale) dhe zëri i tyre ka më shumë ndikim në të gjithë nivelet, nga familja deri në nivel vendi.

Mendoj se kam ndikim ne çeshtjet qe kane te bejne me...



Burrat zotërojnë më shumë ndikim në çështjet që kanë të bëjnë me familjen – më shumë se 60% të respondentëve meshkuj janë përgjigjur ‘gjithmonë’ krahasuar me 45% të respondentëve femra. Sa më e madhe largësia (nga familja në fshat, qytezë, qytet), aq më i ulët ndikimi, trend ky i ngjashëm për të dy gjinitë. Të dy gjinitë mendojnë se nuk kanë fare ndikim në çështjet që janë shqetësuese për shtetin apo komunën e tyre.

Arsimi është një tjetër tregues i qartë i ndikimit, ku personat me shkollim më të lartë ndjehen më të fuqishëm për të ndikuar në vendimmarrjen në çdo nivel. Çdo i dhjeti person me shkollim të lartë beson se gjithmonë ka ndikim në fshatin/lagjen e tij/saj, gjersa dy të tretat besojnë se disa herë kanë ndikim, dhe sa më i ulët shkollimi aq më e ulët ky përceptim.

Dallimi urban/rural gjithashtu nxjerr rezultate interesante. Për derisa banorët urbanë kanë ndikim më të lartë në familje, ndikimi i tyre është më i ulët në lagje, komunë apo në vend krahasuar me banorët në zona rurale. Respodentët që jetojnë në familje më të vogla kanë raportuar një ndikim më lartë sesa ata në familje më të mëdha.

Fjala ime ka peshë në çështjet që kanë të bëjnë me ... (sipas nivelit të arsimimit)									
	Pa arsimim formal	Më pak se arsimim filitor	Arsimim filitor	Më pak se arsimim i mesëm	Arsimim i mesëm	Më pak se arsimim universitar	Diplomë universitare	Diplomë pasuniversitare	Gjithsej
... Familje									
Gjithmonë	47,8%	47,6%	52,4%	41,8%	60,6%	53,9%	62,7%	69,4%	55,6%
Ndonjëherë	52,2%	51,2%	46,7%	56,7%	39,4%	46,1%	37,3%	30,6%	44,0%
Kurrë		1,2%	,9%	1,5%					,4%
... Lagje/Fshat									
Gjithmonë		4,9%	8,5%	7,6%	8,8%	11,0%	12,7%	10,8%	8,9%
Ndonjëherë	47,8%	39,0%	32,6%	37,9%	47,4%	43,3%	42,4%	64,9%	42,1%
Kurrë	43,5%	54,9%	55,4%	53,0%	39,1%	41,7%	42,4%	21,6%	45,4%
Nuk e di	8,7%	1,2%	3,6%	1,5%	4,7%	3,9%	2,5%	2,7%	3,6%
... Komunë									
Gjithmonë			2,7%		1,1%	1,6%	3,4%	2,8%	1,7%
Ndonjëherë	8,7%	6,2%	10,7%	7,6%	10,6%	16,5%	12,7%	30,6%	11,8%
Kurrë	78,3%	92,6%	83,6%	89,4%	86,1%	78,0%	82,2%	66,7%	83,8%
Nuk e di	13,0%	1,2%	3,1%	3,0%	2,2%	3,9%	1,7%		2,7%
... Vendin									
Gjithmonë			1,3%		1,1%		,8%	,0%	,7%
Ndonjëherë		2,4%	2,7%	1,5%	3,3%	3,1%	5,1%	16,7%	3,6%
Kurrë	82,6%	93,9%	92,0%	95,5%	93,1%	88,3%	91,5%	77,8%	91,4%
Nuk e di	17,4%	3,7%	4,0%	3,0%	2,6%	8,6%	2,5%	5,6%	4,3%

Nuk është befasuese se respondentët që janë anëtarë të një partie ndjehen më me ndikim në çdo nivel, nga familja deri në çështjet me rëndësi shtetërore. Viojnë ish-anëtarët dhe më të pafuqishëm ndjehen ata që kurrë nuk kanë qenë anëtarë të një partie.

A ishte zgjedhja juaj e partisë e njëjtë sikurse më 2007? (përpjesë e përgjigjeve gjithmonë)			
	Po	Jo	Nuk kam votuar
Familje	60.5%	67.0%	41.7%
Lagje/Fshat	10.7%	11.8%	5.9%
Komunë	1.7%	1.7%	1.1%
Vendi	.6%	1.1%	.5%

Është befasuese që ata që kanë ndërruar partinë nga viti 2007 deri në 2010 kishin nivelin më të lartë të besimit dhe ndikimit. Shtylla (në tabelën lartë) me votuesit që kanë ndërruar votën e tyre (Jo) është më e lartë sesa ajo e atyre që kanë votuar njëjtë (Po). Ky është tregues se ndërrimi i partisë bëhet nga ata me më shumë guxim të cilët ndjehen më të fuqizuar pas ndërrimit të besnikërisë.

Përpjesa e respondentëve që kanë deklaruar se gjithmonë kanë zë në çështjet që kanë të bëjnë me ... (sipas frekuencës së praktikimit fetar)			
	Shpesh	Rrallë	Kurrë
... familjen	60.7%	54.3%	52.1%
... lagjen/fshatin	11.6%	8.6%	7.4%
... komunën	2.3%	1.9%	1.1%
... vendin	1.7%	.4%	.3%


Kosovarët besimtarë gjithashtu shohin se kanë ndikim të fortë në çështjet familjare dhe në çështje më të larta. Vetëm 50% të respondentëve laikë besojnë se kanë ndikim mbi çështjet që prekin familjet e tyre, krahasuar me mbi 60% të atyre që vijnë më shpesh shërbimet fetare.

Kontakti me përfaqësuesit

Gjasat për t'u takuar me përfaqësuesit politikë është një tjetër tregues i rëndësishëm i fuqizimit dhe llogaridhënies. Ndarja e rezultateve sipas shkallës së shkollimit tregon se individët me shkollim superior janë në pozitë shumë më të mirë për të pasur kontakte me zyrtarët e zgjedhur.


Një trend i ngjashëm vërehet në çdo nivel të qeverisjes, por është veçanërisht i shprehur për nivel qendror. Dallohet fakti se individët me diplomë universitare kanë më shumë gjasa që të takohen me një deputet sesa me një këshilltar komunal apo kryetar komune. Ka shumë më shumë zyrtarë komunalë në numër dhe gjenden më afër në aspekt gjeografik, shumë respondentë mund të mos jenë në dijeni se një person është këshilltar në komunë. Votuesit me shkollim të ulët kanë më shumë gjasa të takohen me zyrtarë të ndërmarrjeve publike (me siguri për t'i paguar faturat e tyre), por kanë më pak gjasa që të bashkëbisedojnë personalisht me zyrtarë të zgjedhur.

Pjesa e të anketuarëve që kanë pasur kontakt me...



Gratë kanë më pak gjasa që të takohen me zyrtarë të zgjedhur sesa burrat. Kjo mund të shpjegohet me faktin që shumica e zyrtarëve të zgjedhur janë burra (dy të tretat). Përveç kontakteve me kryetarin e komunës, gratë kanë më pak gjasa madje edhe në krahasim me kuotën prej 30%.

Kishte kontakte gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit



Është interesante që banorët urbanë kanë më pak gjasa të takojnë një politikan. Banorët urbanë jetojnë në komuna më të mëdha prandaj është e natyrshme që kryetarët e komunës

dhe këshilltarët komunalë të qyteteve të mëdha mund t'i kushtojnë më pak vëmendje qytetarëve të tyre (meqë përmasa e përfaqësimit nënkupton që ka më shumë votues për një këshilltar – rreth 2,600 votues për këshilltarë në qytete krahasuar me rreth 1,200 në komuna më të vogla). Është e habitshme që banorët e kryeqytetit nuk kanë më shumë gjasa për të pasur kontakte me deputetë (dhe kanë më pak gjasa të takojnë kryetarin e komunës personalisht), përkundër afërsisë së tyre gjeografike.

Është e pritshme që familja e madhe është përparësi. Anketa tregon se respondentët e familjeve të mëdha kanë raportuar se janë takuar më shpesh me këshilltarë komunalë apo kryetarin e komunës sesa ata që vijnë nga familje të vogla (11% krahasuar me 6.7%). Shpjegimi mund të jetë se shoqëria kolektiviste u jep rëndësi më të madhe familjeve të mëdha, ose cilido anëtar i familjes që është takuar me një politikanë llogaritet si përfitim për tërë familjen.

Gjasat për të takuar një deputet në 12 muajt e frudit (renditja sipas vijës partiake)




Një analizë krahasuese e ‘kontakteve’ sipas vijës partiake gjithashtu zbulon një trend interesant. Ihtarët e

Vetëvendosjes kanë takuar më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës. Duke marrë parasysh se VV nuk është në mesin e partive më të mëdha, kjo mund të nënkuptojnë vetëm se deputetët e tyre janë shumë më aktivë me votuesit e tyre sesa ata të partive tjera.

Sikurse me treguesit tjerë, praktikimi fetar ka korrelacion pozitiv me gjasat për t'u takuar me zyrtarë të zgjedhur në çdo nivel më shpesh (me së paku 20%).

Ata që kanë pasur kontakte me zyrtarë të zgjedhur gjithashtu besojnë se vota e tyre çon peshë. Është e qartë se komunikimi me qytetarë nga ana e zyrtarëve të zgjedhur rrit votat e partisë dhe pjesëmarrjen e ithtarëve të tyre. Ata që takohen me zyrtarë të zgjedhur kishin më shumë prirje të votojnë njëjtë më 2010 sikurse 2007. Ndryshe, ata që kanë përfiturar më pak vëmendje personale kishin më shumë prirje që të ndërrojnë besnikërinë partiake.

Pjesa e personave që kanë pasur kontakt me zyrtarët e zgjedhur (sipas të ardhurave në Euro)



Kontaktet duket të jenë kryesisht të varura nga anëtarësia në parti. Një anëtar i partisë ka gati dhjetë herë më shumë gjasa të takohet me një deputet sesa dikush që nuk ka qenë kurrë anëtar (21% kundrejt 3%), një këshilltar komunal

(33% kundrejt 5%), apo kryetar komune (29% kundrejt 6%). Kjo tregon se zyrtarët e zgjedhur kryesisht takohen me ithtarë të partisë dhe rrallëherë angazhohen me votues të pavarur.

Përfitimet e komunikimit me qytetarët duket se më shumë i korrin kandidatët specifikë sesa partia. Ata që kanë pasur kontakte me zyrtarë të zgjedhur kanë më shumë vlerësim për kandidatët sesa për partinë (në shkallë më të lartë sesa grupet tjera).


III. Besimi në zgjedhje

Përveç pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të përgjithshëm, është me rëndësi që votuesit të shfaqin besim në vetë institucionin e zgjedhjeve, në rëndësinë e votës, se iu besojnë rezultateve, se besojnë se votimi ishte i drejtë dhe në çfarë shkallë i kanë vërejtur shkelur.

Rëndësia e votimit


Besimi se vota është e rëndësishme është tregues i rëndësishëm i gjendjes së demokracisë në një shoqëri të caktuar. Banorët ruralë të Kosovës kanë besim më të madh në votë sesa banorët urbanë (ku qytetarët e Prishtinës kanë më së paku besim). Ekziston një trend i butë, ku individët më të arsimuar kanë më pak besim në fuqinë e votës që vërejtshëm në procesin e zgjedhjeve.

Arsimimi rritë besimin në votim



Ekziston një dallim i vogël ndërmjet gjinive në lidhje me rëndësinë që ata i kushtojnë votës. Burrat kanë më shumë dyshime dhe besojnë se vota e tyre ka fuqi të kufizuar, gjersa gratë kanë prirje t'i besojnë më shumë votës (3% më tepër) por edhe të përgjigjen më shumë me 'nuk e di' (5% më tepër).

Besimi se vota personale ka ndikim (sipas gjinisë)




Banorët e viseve rurale dhe fshatrave i besojnë fuqisë së votës më shumë se banorët urbanë. Afër 70% të banorëve ruralë besojnë se vota ndikon në politikëbërje, krahasuar me 60% të respondentëve në Prishtinë dhe 65% në qytetet tjera.

Analiza krahasuese e rezultateve sipas partive politike gjithashtu ka nxjerrë rezultate interesante. Ndonëse ithtarët e Vetëvendosjes shohin më shumë mashtrime, në të

njëjtën kohë ata e shohin votën si shumë të rëndësishme. Një pjesë e madhe e ithtarëve të LDK-së duket se janë pajtuar me perceptimin se vota është pafuqishme.


Vota ka ndikim (sipas partisë)




Zgjedhje fer

Rëndësia që i jepet zgjedhjeve ndikohet nga besimi se organizimi i zgjedhjeve ishte fer ku mbi 44% të respondentëve janë përgjigjur se ato nuk ishin fer.

Zgjedhjet e fundit ishin




Rezultatet e zgjedhjeve reflektuan votën fer




Shumica e kosovarëve ishin dukshëm të zhgënjyer me mbarëvajtjen e procesit të votimit. Gratë kanë prirje më shumë t'i besojnë se zgjedhjet ishin fer (30% krahasuar me 22% të burrave), por duhet të theksohet se pjesëmarrja e grave në zgjedhje është për rreth 30 për qind më e ulët sesa ajo e burrave. Kosovarët e rinj janë më kritikë sesa të moshuarit. Votuesit e arsimuar kanë prirje të jenë më kritikë ndaj mbarëvajtjes së zgjedhjeve sesa ata më pak të arsimuar. Kategoria e vetme që e konsideron mbarëvajtjen e zgjedhjeve si të drejtë ishte ajo e personave pa shkollim formal. Në të gjitha kategoritë tjera, përpjesa e atyre që mendonin se procesi nuk ishte i drejtë ishte dyfish më e madhe, me trend përkeqësues gradual që vijon vitet e arritjes akademike.

Militantët e partisë i besojnë më shumë mbarëvajtjes zgjedhore (index)



Është e kuptueshme që votuesit që i besojnë procesit kanë prirje t'i favorizojnë partitë dhe ata që kanë më pak besim, anojnë drejt kandidatit (ndonëse kauzaliteti sigurisht funksionon në dy anët). Një analizë e ngjashme krahasuese gjithashtu nxjerr përfundimin se ata që e panë procesin si të padrejtë kishin prirje që të ndryshojnë se për kë votojnë dermjet vitit 2007 dhe 2010 (grafikoni më poshtë).

Zgjedhjet e padrejta çojnë votuesit për të ndryshuar besnikërinë partiake (indeks)



Nuk ka trend të caktuar përgjatë vijave partiake. Shumica e respondentëve që kanë votuar për Vetëvendosjen apo LDK-në mendojnë se zgjedhjet kanë qenë të padrejta apo deri diku të padrejta. Votuesit e PDK-së, në anën tjetër, mendojnë se zgjedhjet kanë qenë të drejta apo deri diku të drejta dhe vetëm një numër i vogël i përgjigjeve janë përgjigjur se ato ishin të padrejta.


Besimi në rezultate

Pjesë e rëndësishme e procesit zgjedhor është numërimi dhe ky proces është kontestuar në ciklet e fundit të zgjedhjeve. Është dëshpërues fakti që më shumë kosovarë besojnë se rezultatet nuk pasqyrojnë drejtë mënyrën si kanë votuar (gati një e treta e kosovarëve nuk pajtohen aspak gjersa vetëm 12% pajtohen plotësisht).

Trendi kryesor shfaqet kur i analizojmë rezultatet sipas anëtarësisë partiake, ku ithtarët e partisë kryesorë kanë prirje t'i besojnë rezultateve më shumë se të tjerët. Ithtarët e PDK-së kryesisht besojnë se rezultatet pasqyrojnë mënyrën se si kanë votuar qytetarët, gjersa shumica e ithtarëve të


Vetëvendosjes nuk pajtohen aspak. ithtarët e LDK-së, AAK-së dhe AKR-së kanë prirje të përgjigjen në mënyrë më pak radikale. Kjo pyetje nuk matë saktësinë e rezultateve, por ilustron përceptimin e një besimi të zbehtë në integritetin e votës dhe procesit të numërimit.

Rezultatet reflektojnë se si njerëzit votuan




Mosbesimi në rezultatet e zgjedhjeve vjen kryesisht nga Prishtina, banorët e të cilit vend janë më dyshuesit ndaj rezultateve, gjersa votuesit rural janë më pak kritikë dhe të cilët besojnë se rezultatet pasqyrojnë votën e tyre.

Besimi në rezultate (sipas partive)



Personat që kanë ndryshuar përcaktimin e tyre të votimit nga viti 2007 në 2010 ishin të mendimit se rezultatet e zgjedhjeve nuk pasqyronin synimin e votimit. Kjo tregon se mashtrimi shtyn votuesit që të ndërrojnë partinë apo të mos votojnë fare (shih grafikunin më poshtë).

Besimi në Rezultate ndikon zgjedhjen e votuesit




Shkeljet

Incidentet e shkeljeve që votuesit i kanë vërejtur është një tjetër tregues i dobishëm i procesit zgjedhor. Respondentët janë pyetur nëse kanë vërejtur presione ndaj votuesve, blerje të votave, votime të shumëfishta apo votime familjare. Ata janë pyetur se në çfarë mënyre i kanë marrë ato informata, nëse kanë dëgjuar për incidente të tilla në lajme, nëse u kanë treguar miqtë apo të afërmit, apo nëse i kanë parë vetë apo iu kanë ndodhur atyre.


Më pak se gjysma e respondentëve janë përgjigjur se nuk kanë parë apo dëgjuar për shkeljet e lartcekura, gjysma tjetër theksuan se kanë dëgjuar nga mediat apo nga të tjerët, dhe rreth 5% janë përgjigjur se kanë parë raste të tilla apo ato iu kanë ndodhur atyre.

Shkeljet



Kategoria e mesme dhe e fundit janë më problematike. E treta në veçanti është kategoria e personave që kanë pasur përvojë personale me mashtrime. Në një tryezë të rumbullakët të mëhershme ku i kemi prezantuar këto të dhëna, disa diskutues ishin të mendimit se shkalla prej 4-5% ishte më e ulët se ajo që kishin pritur. Por kjo përqindje fsheh diç brengosëse, sepse çdo i njëzeti votues personalisht ka përjetuar apo vëzhguar mashtrim.

E kam pa vetë




Nëse secili incident i mashtrimit ka përfshirë një votë të vetme, atëherë rreth 5% (baras me pesë deputetë) kanë qenë

të manipuluar. Por shumica e shkeljeve përfshinin disa vota, prandaj shkalla e vjedhjes së votave është me siguri shumë më e lartë.

Mënyra se si votuesit i vërejnë shkeljet dhe si krijojnë një opinion qartas ndikohet nga gjinia, niveli i shkollimit, si dhe faktorë tjerë demografikë. Ata që kanë qenë dëshmitarë të shkeljeve të ndryshme kanë ndërruar besnikërinë partiake në një shkallë më të madhe (me rreth 10% më shumë se të tjerët).

Votimi Familjar (sipas moshës)



Mosha ka një ndikim mjaft të madh, meqë kosovarët në moshë më të shtyrë kanë nivel më lartë të tolerancës për disa probleme të shpeshta të cilat i pranojnë si normale. Shumica e responentëve të moshuar kanë raportuar se nuk kanë vërejtur votim familjar, gjersa shumica e të rinjve theksojnë të kundërtën. Ky përceptim i kundërt me siguri nuk është dallim në vrojtim, por ka të bëjë me faktin se të rinjtë janë më të vetëdijshëm që votimi familjar përbën shkelje, ndryshe nga gjyshërit e tyre.

Ngjashëm, kosovarët e rinj kanë vërejtur më shumë presion ndaj votuesve sesa të moshuarit. Rreth 7% të kosovarëve të moshës 18-39 vjeç personalisht kanë përjetuar shkelje,

krahasuar me vetëm 2% për respondentët e moshuar.

I njëjti trend vërehet kur analizojmë rezultatet sipas shkallës së arsimit, ku personat me shkollim më të lartë vërejnë votim familjar më shpesh sesa ata me më pak shkollim. Nëse përhapja e institucioneve të shkollimit të lartë nuk i jep Kosovës përparësi në shkencë, së paku ndoshta ndihmon për një skenë politike më dinamike.

Anëtarët e partisë i shohin shkeljet më mirë sepse ata janë më të interesuar që të identifikojnë dhe denoncojnë blerje të votave, presion dhe forma të tjera të shkeljeve nëse dyshojnë në praktika të padrejta. Votuesit e rastësishëm dhe anëtarët e partive më së shpeshti dëgjojnë për shkelje të shumta nga mediat dhe të tjerët, ndonëse kanë më shumë prirje sesa gratë që t'i shohin dhe dëgjojnë parregullsitë vetë.


IV. Sistemi zgjedhor dhe sjellja votuese

Gama e pyetjeve që kanë vlerësuar sistemin dhe sjelljen votuese në përgjithësi kishin për qëllim të zbulojnë nëse respondentët (a) favorizojnë partinë apo kandidatët individualë (dhe rrjedhimisht nëse parapëlqejnë lista të hapura apo të mbyllura), (b) kanë votuar njëjtë në zgjedhjet 2010 sikur më 2007, (c) kanë votuar njëjtë në zgjedhjet lokale 2009 dhe në zgjedhjet e përgjithshme më 2010, (d) kur kanë vendosur votuesit për kë të votojnë (para apo gjatë fushatës), (e) si vendosin për kandidatët, dhe (f) në çfarë kohe të ditës kanë votuar.

Partia apo kandidatë individualë?

Shumica e respondentëve parapëlqejnë lista të hapura, 60% kundrejt 33% që favorizonin listat e mbyllura. Kjo tregon një parapëlqim për përzgjedhje individuale, por edhe mosbesim ndaj lidhshimit të partisë.

Për lista të hapura apo të mbyllura?



Kur janë pyetur ndryshe për të njëjtën mëdyshje, respondentët gjithashtu kanë deklaruar se individët janë më të rëndësishëm sesa partia. Kjo tregon se skena partiake nuk është konsoliduar dhe se kosovarët preferojnë që të mos konsolidohet ashtu siç është.


Është me rëndësi të analizohet kjo preferencë sipas tipareve të ndryshme demografike. Gratë parapëlqejnë lista të hapura ndaj

atyre të mbyllura, por preferenca nuk është aq e theksuar

sikurse tek burrat. Gratë mbështesin listat e mbyllura në shkallë prej 35%, krahasuar me 31% tek meshkujt. Ato gjithashtu kanë prirje të përgjigjen me ‘nuk e di’ në një shkallë më të lartë sesa burrat (11% krahasuar me 6%).

Mbështetja për listat e hapura rritet me moshë (me përjashtim të grupmoshës prej mbi 70 vjeçe). Arsimimi është po ashtu një tregues i fortë, ku mbështetja për lista të hapura rritet në masë drastike me shkollim të lartë.


Lista të hapura apo të mbyllura? (sipas edukimit)



Kosovarët fetarë dhe jofetarë favorizojnë lista të hapura, ndonëse grupi i dytë janë përkrahës më të flaktë. Të ardhurat gjithashtu përcaktojnë mbështetjen për lista të hapura, kur kosovarët me të ardhura më të mira mbështesin listat e hapura në raport 8 me 1, gjersa kosovarët më të varfër memzi mbështesin ato më shumë se listat e mbyllura.


Duket se aleancat personale kanë filluar ta ndryshojnë dinamikën brenda partive politike. Kosovarët që janë anëtarë të partive politike mbështesin listat e hapura, gjersa ish-anëtarët favorizojnë listat e mbyllura. Përkrahja më e madhe për lista të hapura vë nga ata që asnjëherë nuk kanë qenë anëtarë të partive.

Shkoi me të vjetrin, erdhi me të riun




Pyetja nëse respondentët favorizojnë partinë apo kandidatin ka nxjerrë përgjigje shumë të ngjashme por më pak të mprehta sesa kur janë pyetur për listat e hapura. Gjersa kjo mat pak a shumë të njëjtën çështje, përgjigjet tregojnë se publiku është dukshëm më i ndërgjegjshëm dhe ka opinion të fuqishëm për debatin e listave të hapura/mbyllura. Listat e hapura kohëve të fundit po sulmohen sepse shpeshherë janë fajësuar nga kritikët se kanë mundur mashtime. Qëndrimi i D4D-së është se vota preferenciale është ajo që bën të mundur

A është më e rëndësishme partia apo kandidati?



mashtimin. Listat e hapura nuk duhet të fajësohen, por ato duhet të avancohen me tipare tjera. Ne jemi të kënaqur që opinioni publik beson se listat e hapura duhet të mbesin.

Çfarë është më e rëndësishme kur voton? (sipas afërsisë me një parti)



Respondentët që ndjehen të afërt me një parti favorizojnë partinë gjersa kosovarët që kanë lidhje të lehta me partitë më tepër parapëlqejnë kandidatët.


Përzgjedhja votuese

Më 2010, personat në gjendje më të mirë ekonomike kanë votuar kryesisht për PDK, LDK dhe VV. AAK ka tërhequr më shumë votues nga grupi i personave me të ardhura mesatare, gjersa AKR ka fituar më shumti mbështetje nga të varfrit. Është interesant se kur janë pyetur se si do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin të dielën e ardhshme, trendi i të ardhurave më nuk është tregues. Nuk ka parti të posaçme që pritet të korrë rezultate më të mira tek të varfrit apo të pasurit.


Diagrami në faqen tjetër tregon përgjigjet e pyetjes se do të votonit nëse zgjedhjet do të mbaheshin të dielën e ardhshme. Ndarja e synimeve të votimit sipas profileve të ndryshme demografike shfaq trende befasuese. Për shembull, të gjitha partitë tradicionale janë krahasueshmërisht më të forta tek personat me shkollim më

të ulët, por kanë humbur përqindje karshi Vetëvendosjes tek personat me shkollim të lartë.

Interpretimi i votimit (sipas gjinisë)




Si do të votojnë qytetarët e edukuar?




Synimet e votimit janë të lidhura ngushtë edhe me grupmoshat (shih grafikun më poshtë).

Synimet e votimit (sipas grupmoshave)



Edhe besimi fetar nxjerr rezultate interesante. Përveç koalicionit KKR që ka dukshëm përqindje më të madhe të votuesve fetarë, LDK ka përqindje të lartë të të moshuarve të cilët janë praktikues të fesë më shumë se të tjerët. AAK ka dukshëm mbështetje më të lartë të votuesve laik.

Zgjedhja e partisë 2010 (sipas fesë)




Përzgjedhja e partisë

Skena partiake në Kosovë shpeshherë është quajtur statike. Partitë e reja nuk kanë kurajo pasi që sipas tyre skena nuk ndryshon. Por anketa dëshmon të kundërtën.

Një e pesta e respondentëve kanë raportuar se kanë ndryshuar partinë e preferuar nga 2007 në 2010. Gjysma

A ishte zgjedhja e juaj e partisë e njejta sikurse në vitin 2007?



kanë votuar njëjtë, që përshkruan një skenë shumë më jostabile partiake sesa që është menduar.


Votuesit më të arsimuar kanë prirje të ndryshojnë votën e tyre më shpesh se të tjerët, sikurse që kanë vepruar votuesit që vinin nga familjet e vogla. Një e katërta e votuesve që jetojnë në familje të vogla (1-3 anëtarë) kanë votuar ndryshe, krahasuar me 16% të atyre në familje prej katër apo më shumë anëtarë. Kosovarët që nuk besojnë se votimi është

instrument i rëndësishëm për të ndikuar në politika kanë prirje që ti përmbahen të njëjtës parti, gjersa ata që besojnë ndryshe kanë prirje të tërhiqen dhe të mos votojnë.

Analizimi i kësaj pyetje duke e krahasuar me perceptimin nëse zgjedhjet ishin fer tregon se kosovarët më të vërtetë brengosen me manipulimin e zgjedhjeve. Ata që besojnë se rezultatet e zgjedhjeve të fundit ishin të drejta kanë vazhduar të votojnë në të njëjtën mënyrë. Personat që kanë ndërruar partitë e tyre kanë prirje ta shohin dhe të preken nga mungesa e drejtësisë. Kjo tregon se mashtrimi zgjedhor ka ndikim të dukshëm në përzgjedhjen votuese dhe do të

shkonte në favor të partive të mëdha nëse do të zvogëloheshin mashttrimet (shih diagramin më poshtë dhe në kapitullin e mëhershëm).


Besimi nëse zgjedhjet janë të drejta ndikojnë në votë



Është e logjikshme që anëtarët e partisë nuk ndërrojnë besnikërinë shpesh, ku 70% kanë vazhduar të njëjtën përzgjedhje ndërmjet 2007-2010 (që është më e ulët se që kemi pritur duke marrë parasysh se fjala është për militantët më të besueshëm). Jo-anëtarët kanë prirje të ndryshojnë partinë më shpesh, meqë më pak se gjysma kanë votuar njëjtë.

Është me rëndësi të analizohet se çfarë cilësish kërkojnë votuesit dhe çfarë shohin ata tek partinë aktuale. Anketa gjithashtu ka pyetur për cilësitë e partisë dhe për arsyet që kanë shtyrë votuesit që të përzgjedhin një parti të caktuar; për shkak të liderit, cilësisë së ekipit, e kishin një të afërm në parti, apo të tjera (shih grafikun në faqen tjetër).

Cilësitë e Partisë




Në masë më të madhe, PDK-ja dhe LDK-ja tërheqin më shumë votues për shkak të lidhjeve që tregojnë se ata kanë rrjetin më të gjerë të patronazhit. LDK mobilizon një çerek të votuesve të saj për shkak të liderit, gjersa 30% e përzgjedhin atë për angazhimin e saj në të mirë të Kosovës, vijuar nga 16% të cilët e ndjekin cilësinë e programit. AAK tërheq votuesit përmes liderit të saj, për shkak se janë anëtarë, apo për shkak se e njohin dikë aty. Interesat e Kosovës janë arsyeja pse një e treta e përkrahësve të VV-së e përzgjedhin këtë lëvizje, vijuar nga 25% për shkak të cilësisë së programit dhe 17% për liderin.

Është interesante të shihet se shkalla e përgjigjeve që kanë refuzuar apo nuk e dinin është më e larta në pyetjen për cilësinë e programit apo për shkak të kandidatëve më të mirë në listë. Vetëm 5-6.5% të respondentëve citojnë cilësinë e ekipit si arsyeja për ta votuar partinë, por kjo shkallë rritet për personat në pozitë më të mirë ekonomike (gati një e pesta). Rreth 4% përzgjedhin partinë e tyre ose për shkak se e njohin dikë apo kanë familjarë në atë parti. Anëtarët e partisë më shpesh e përmendin liderin e partisë si arsye për ta votuar, gjersa ish-anëtarët apo përkrahësit që nuk janë anëtarë përmendin arsye tjera për ta votuar partinë. Analiza krahasuese në vijim paraqet përpjesën e cilësive që votuesit i kanë parë në secilën parti.

Diagrami i mëposhtëm përshkruan përzgjedhjen e dytë të votuesit, i pyetur se për kë do të votonte nëse partia e preferuar nuk do të merrte pjesë në zgjedhje. Përzgjedhja e dytë është e rëndësishme për të vlerësuar: (a) cila parti me gjasë do të kapitalizonte nga zemërimi me partitë në pushtet, dhe (b) kandidatët për kryetarë komunash të cilët kanë gjasë që të përfitojnë mbështetjen e të tjerëve në balotazh.


Zgjedhja e dytë nëse partia juaj nuk merr pjesë në zgjedhje? (sipas lidhjes partiake)



AAK është përzgjedhja e dytë më e shpeshtë për shumicën e kosovarëve, nëse partia e tyre nuk do të merrte pjesë në zgjedhje apo nëse kandidati i tyre humb në raundin e parë dhe kjo është posaçërisht e vërtetë për grupmoshat deri 50 vjeç. Ndonëse është partia e dytë për nga madhësia, LDK shihet si zgjidhje e sigurt për kosovarët e të gjitha moshave, por nuk është partia primare për të tërhequr votën e zemërimit ndaj qeverisë. Vetëvendosje dhe AKR duken më të forta tek grupmoshat e reja (nën moshën 30 vjeç) ku ata gëzojnë besimin e 8% krahasuar me grupmoshat tjera me mesatare prej 3.5-4%.

Anketa gjithashtu ka pyetur nëse votuesit kanë votuar njëjtë në zgjedhjet lokale dhe ato të përgjithshme dhe analiza krahasuese e partive është paraqitur vizuelisht më poshtë. Arsyja pse AAK ka bazë më të padisiplinuar votuesish nga zgjedhjet lokale në ato të përgjithshme është se arrin në balotazh në më pak komuna sesa dy partitë kryesore, prandaj aty ku është një parti e tretë apo e katërt ajo tërheq më pak vota për kryetar komune sesa për llojet tjera të zgjedhjeve.


Votuan të njëjtit në zgjedhjet Nacionale & Lokale (sipas synimeve partiake)




Efkti i fushatës

Kjo pjesë vijon me analizën se në çfarë shkallë votuesit kanë ndërruar përzgjedhjen e tyre partiake. Ndryshe nga pjesa e mëparshme, kjo pjesë bën përpjekje të përgjigjet edhe në atë se kur ndodh ndryshimi i votës. Vendimi për këtë të votohet merret nga votuesit më shumë se një muaj paraprakisht (58.8%). Kjo lë mbi 40% që të vendosin brenda një muaji të vetëm ku supozohet se të gjitha partitë trajtohen njëjloj.

Vendimi për të votuar (sipas gjinisë)



Vendimi për të votuar (sipas edukimit)




Gratë kanë prirje të ndikohen më shumë nga fushata. Një pjesë më e madhe e grave vendosin gjatë muajit të fushatës, 5 ditë para ditës së zgjedhjeve, si dhe në ditën e zgjedhjeve. Personat më të shkolluar ndikohen më pak nga fushata. Vetëm 8% e respondentëve me diplomë universitare apo më të lartë vendosin ditën e zgjedhjeve, krahasuar me rreth 18% për respondentët me shkollim fillor apo më pak.

Kosovarët që kanë ndërruar përzgjedhjen e tyre të votimit ndërmjet 2007 dhe 2010 vendimin e kanë marrë në kohë të ndryshme. Rreth një e katërta kanë vendosur shumë kohë para fushatës, një çerek tjetër gjatë fushatës, por gati një e treta disa ditë para zgjedhjeve dhe ditën e zgjedhjeve.

Analiza krahasuese sipas partisë nxjerr rezultate të mahnitshme. Shumë votues të AAK-së kanë vendosur të votojnë për ta ditën e zgjedhjeve, që është në përputhje me përzgjedhjen e tyre si opsioni i dytë i sigurt, por gjithashtu nënvizon një bazë jo të qëndrueshme zgjedhore, e cila mund të ikë nëse bëhen gabime. Si parti e re, as votuesit e AKR-së nuk janë të 'lidhur' për partinë. Meqë shumica e votuesve të tyre vendosin për të votuar për ta gjatë fushatës, baza e votuesve të tyre është në largim dhe e paqëndrueshme. Si përpjesë e bazës së tyre të votuesve, shumica e votuesve të Vetëvendosjes janë përcaktuar shumë kohë para fushatës.


LDK gjithashtu ka një bazë të qëndrueshme të votuesve, por hisja e saj e votuesve të qëndrueshëm është më e zbehtë se ajo e VV. PDK ka fushatat më të mira, meqë një pjesë e madhe votuese e saj duket se përcaktohet gjatë kësaj periudhe, ndonëse ka një bazë të madhe të qëndrueshme (më të madhe se të tjerët në numra, por jo si proporcion i madhësisë së saj).

Kur vendosin votuesit se për kë të votojnë? (sipas lidhjes partiake)



Votuesit të cilët kanë cekur ekipin dhe cilësinë e programit si prioritet kanë prirje të përcaktohen shumë kohë para zgjedhjeve për partinë që do ta votojnë, gjersa një pjesë më e madhe e atyre që anojnë nga liderët kanë prirje ta shtyjnë vendimin e tyre përfundimtar deri në fushatë apo deri ditën e zgjedhjeve. Rreth 8% e shohin listën e kandidatëve si kriterin më të rëndësishëm dhe shumica e tyre vendosin gjatë fushatës dhe ditët e fundit në prag të ditës së zgjedhjeve.

Votuesit vendosin se për kë të votojnë ... (sipas të ardhurave)



Kur i shohim të dhënat sipas të ardhurave gjithashtu vërejmë një trend të butë por gjithsesi të pranishëm ku të varfrit dhe të pasurit kanë prirje të jenë votues të qëndrueshëm, ndërsa klasa punëtore është ajo që ende është në kërkim e sipër të një strehe të përhershme politike.

Përzgjedhja e kandidatit dhe koha e votimit

Mënyra se si votuesit kanë vendosur t'i shënjojnë emrat e kandidatëve individualë (duke pasur parasysh 5 mundësitë për Kuvend të Kosovës) është po ashtu me rëndësi meqë kjo përfundimisht vendos për përbërjen e organit tonë më të

lartë legjislativ. Afër një e katërta e respondentëve kanë raportuar se kanë përzgjedhur pesë emrat e parë në mënyrë të shpejtë, që humb qëllimin e listave të hapura, sikurse që e bën të njëjtën edhe 12% të cilët votojnë sipas sugjerimeve të liderit. Vlera e vërtetë e listave të hapura mbetet të përcaktohet nga votuesit të cilët përzgjedhin kandidatët e dëshmuar profesionalisht (36%), apo nga i njëjti qytet (11%), apo të cilët i njohin personalisht (7%), etj.


	Përzgjedhja e Kandidatëve
Shumë shpejt i zgjodhi 5 emrat e parë	23%
Kandidatët nga qyteti juaj	11%
Kandidatët e moshës tuaj apo gjinisë	1%
Kandidatët që i njoh personalisht	7%
Kandidatët e afërt me kryetarin apo të propozuar nga partia	12%
Kandidatët e vërtetuar profesionalisht	36%
Kandidatët e vërtetuar gjatë luftës	5%
Të tjerë/Nuk tregon/Nuk e di	4%

Në çfarë kohe të ditës votuesit shkojnë në vendvotim për të hedhur votën duket të jetë informatë e parëndësishme por nuk është e tillë. Ekziston një trend për disa palë zgjedhje në Kosovë, ku pas orës 17.00 kemi një pjesëmarrje tepër të lartë që është e dyshimtë. Nëse i pyesim votuesit se kur kanë votuar mund të na shpie në mospërputhje të mundshme ndërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje të vërejtur gjatë Ditës së Zgjedhjeve (të raportuar në publikimin tonë për zgjedhjet e parakohshme në Ferizaj dhe Kaçanik³) dhe përgjigjeve të respondentëve në anketë. Vëzhguesit raportojnë edhe pjesëmarrjen e votuesve mashtrues të cilët mund të votojnë në emër të të tjerëve apo disa herë, të cilën gjë anketa nuk

³ Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?. http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_KacanikFerizaj.Eng_.pdf

mund ta tregojë. Nëse dallimi është mjaft i madh dhe statistikisht relevant, atëherë ky mashtrim mund të dëshmohet se ekziston dhe është masiv.

Koha e votimit (sipas gjinisë)



Është gjithashtu interesant të shihen trendet gjinore për kohën në të cilën dalin për të hedhur votën. Gratë votojnë më pak posaçërisht në periudhën 13.00-15.00 dhe më shumë në periudhën 09.00-11.00 dhe 15.00-17.00. Ndarja sipas moshës tregon se të moshuarit kryesisht votojnë në mëngjes. Gjithashtu, ekzistojnë disa trende të lehta përgjatë partive. Votuesit e LDK-së kanë prirje të votojnë më shumë në mëngjes, gjersa të Vetëvendosjes në orët më të vonshme.


V. Pritjet e lidershipit

Një pjesë e rëndësishme e ushtrimit demokratik janë arsyet pse individët votojnë për një lider dhe jo për të tjerët. është thelbësore të vlerësohet se çfarë cilësish kërkojnë votuesit tek liderët, meqë përfundimisht një gjë e tillë dikton llojin e qeverisjes që marrim si pasojë.

Çfarë liderësh dëshirojnë kosovarët në përgjithësi?


Pothuajse të gjithë kosovarët mendojnë se atributet më të rëndësishme që i kërkojnë tek liderët janë shkollimi, pasuar nga njohuria, të mos jenë të korruptuar, moralë, guximtarë, punëtorë dhe vizionarë (shih grafikonin në faqen e ardhshme). Pjesëmarrja në luftë më nuk është e rëndësishme, që tregon një pjekuri gjithnjë më të madhe të politikës pragmatike tek votuesit.

Përkrahësit e partisë që mendojnë se është shumë me rëndësi që lideri të jetë i dijshtëm




Për t'i dalluar preferencat dhe vlerat sipas vijave partiake, i kemi analizuar rezultatet sipas lidhjes partiake. Shumica e vlerave janë të përbashkëta për të gjitha partitë, por disa më pak se tjerat. Për shembull, praktikisht të gjithë përkrahësit e LDK-së vlerësojnë njohurinë si të domosdoshme për liderët, gjersa kjo vlerësohet më pak nga votuesit e AAK-së.

Vlerat më të rëndësishme për një lider



Ekzistojnë disa dallime gjinore për veçoritë, ku kryesisht gratë nuk ndajnë mendimin se të qenit vizionar apo i përkushtuar në kauza më të larta është shumë me rëndësi. Ekziston një trend partiak ky përkrahësit e Vetëvendosjes vlerësojnë vizionin më shumë se të tjerët.

Përkrahësit e partisë që mendojnë se është shumë me rëndësi që lideri të jetë vizionar




Çfarë mendojnë kosovarët për liderët aktualë?

Gjersa pyetja e mëhershme mat përciptimin për vlera në përgjithësi pa pasur parasysh emra të përveçëm, një pyetje tjetër ishte se cilat veçori i vlerësojnë më shumë tek liderët aktualë. Ne e kemi vlerësuar popullaritetin e përgjithshëm si dhe atë që votuesit saktësisht e shohin tek liderët e caktuar.

Kryeministri aktual, Hashim Thaçi, shquhet për dy cilësi: është lider i fortë dhe nxit shpresë. Kryetari i partisë së dytë për nga madhësia dhe Kryetar i Komunës së Prishtinës shquhet si njeri i ditur dhe i ndershëm. Haradinaj shihet si i fortë por edhe si një person që sjell ndryshim. Kurti vlerësohet po aq lartë në shumicën e cilësive, përveç asaj si lider i fortë. Pacolli radhitet lartë me kujdesin për njerëzit. Gjithashtu, e kemi vlerësuar edhe imazhin e figurave tjera, ku Surroi është asocuar ekskluzivisht me diturinë gjersa Jakup Krasniqi me sinqeritetin.

Tiparet e udhëheqësve aktual



Të njëjtit dy liderë që japin më së shumti shpresë janë po ata që ndjellin më së shumti frikë tek populli (17% janë përgjigjur se i frikësohen Thaçit dhe 10% i frikësohen Kurtit). Gati çereku i respondentëve janë përgjigjur se asnjë lider nuk u jep shpresë. Kur janë pyetur se kush do të sjellë ndryshim, Haradinaj i bashkohet Thaçit dhe Kurtit. Më shumë se një e treta e respondentëve janë përgjigjur se asnjë lider nuk kujdeset për popullin.


Gjithashtu ka trende tek gjinia. Për sa i përket përgjigjes ‘të jetë lider i fortë’, gratë kanë prirje të vlerësojnë Hashim Thaçin më shumë sesa burrat, dhe më pak e vlerësojnë Ramush Haradinajn apo Jakup Krasniqin. Burrat e shohin Surroin, Kurtin dhe Mustafën si më të dijsëm, por gratë të njëjtën cilësi e shohin tek Thaçi.

Faktori më i dukshëm që dallon besnikërinë tek ithtarët e partive duket të jetë mosha (shih grafikonin në faqen paraprake). Nëse ‘të tjera’ apo ‘asnjë’ do të ishin emra të vërtetë të liderëve, ata do të kishin qenë më popullorët.

Kurti gëzon shkallën më të lartë të popullaritetit tek votuesit më të rinj (18-29) dhe është më pak konkurrent tek grupmoshat tjera. Grupmosha e radhës, 30-39, preferon Thaçin, Mustafën dhe Jahjagën. Grupmosha më e pakënaqur me të gjithë liderët është ajo 40-49. Nga të paktët që kanë cekur liderët favoritë, Thaçi dhe Mustafa janë vlerësuar më së larti. Më të moshuarit (>69) favorizojnë dukshëm Isa Mustafën, ndonëse të moshuarit (> 50) favorizojnë edhe Haradinajn.

Përveç popullaritetit dhe veçorive, gjithashtu e kemi vlerësuar edhe nivelin e disiplinës tek përkrahësit dhe nivelin e komunikimit me popullatën e përgjithshme. Grafikoni në faqen e ardhshme shpjegon popullaritetin e liderit tek votuesit e tij si dhe në mesin e përkrahësve të partive tjera.

Mbështetja e liderëve nga grupmoshat e ndryshme




Përveç vlerësimit të popullaritetit tek përkrahësit e tyre, është me rëndësi të matet popullariteti i liderëve tek popullata e përgjithshme. Një indikator që e kemi vlerësuar ishte shkalla e pëlqimit dhe mospëlqimit nga përkrahësit e partive tjera (shih grafikonin në faqen tjetër).


Kurti gëzon popullaritetin më të madh tek votuesit e Vetëvendosjes (krahasuar me liderët tjerë tek votuesit e tyre). Mustafa mobilizon më së paku ithtarët e partisë së tij, por gëzon mbështetje të konsiderueshme nga ithtarët e AKR-së. Një pjesë e konsiderueshme e votuesve të LDK-së nuk favorizojnë asnjë lider, përpjesë kjo që tejkalohet vetëm nga përkrahësit e PDK-së. Pacolli gëzon mbështetje modeste tek partia e tij, por ka mbështetje më të ulët të liderëve nga përkrahësit e partive tjera.

Grafikoni në faqen tjetër nuk përfshin LDD, të cilën e kemi paraqitur ndaras më poshtë. Është me rëndësi të paraqitet një diagram për votuesit e LDD-së (sado pak që janë) meqë kjo parti po tretet dhe votuesit u shkojnë tjerëve. Edhe pse ka arritur koalicion me AAK-në, shumica e ndjekësve të tyre kanë mendim pozitiv për Mustafën, gjersa Haradinaj është opsioni i tyre i tretë më i preferuar (nga kjo listë).

Çfarë mendojnë votuesit e LDD-së për liderët e tjerë?




Mbështetja për liderin nga radhët e përkrahëse të partisë së tij dhe të partive të tjera



Ndoshta më interesante është të vlerësohet se prej nga vjen mbështetja për Presidenten aktuale Jahjaga, pavarësisht që ajo asnjëherë nuk iu ka nënshtruar testit zgjedhor (shih faqen e ardhshme). Ajo shihet si më e favorshmja nga përkrahësit e AKR-së (dhe PD-së) dhe të AAK-së, vijuar nga LDK dhe PDK. Opozitën më të theksuar ajo e ka nga votuesit e Vetëvendosjes dhe nga ata që kanë theksuar se nuk do të votojnë.

Popullariteti i Jahjagës (sipas vijës partiake)



Konkluzë

Kosovarët janë kryesisht të shqetësuar me zhvillimin ekonomik dhe gjithnjë e më shumë po kërkojnë cilësi pragmatike tek liderët e tyre. Është e dukshme që veçoritë që kërkojnë nga liderët janë në evolucion sipër dhe se tiparet që kërkojnë tani nga liderët nuk janë ato që do të shpiejnë Kosovën në klubin më ekskluziv të kombeve demokratike.

Partitë janë ende në hapat e parë drejt identifikimit të grupeve të votuesve që më së miri iu përshtaten qëndrimeve të tyre. Ne besojmë që 4-5 vitet e ardhshme do të jenë vendimtare në atë se si do të pozicionohen partitë dhe se çfarë do të kërkojnë votuesit. Kandidatët gjithnjë e më shumë do të flasin për shqetësimet dhe interesat e grupeve të përkufizuara mirë dhe do ta ndërtojnë një bazë të votuesve që është më pak gjeografike.

Ne shpresojmë se partitë do të marrin parasysh disa nga konkluzat dhe do të kuptojnë se nëse takohen më shumë me votuesit e pavarur do të arrijnë të mbledhin më shumë vota nga radhët e tyre. Kandidatët duhet ta shohin perspektivën afatgjatë, ndërsa ne shpresojmë që të gjithë zyrtarët e zgjedhur do të motivohen nga më shumë se një pagë për katër vite.

Me një arsimim më të madh, votuesit rural mund të bëhen më dyshues dhe mund të kërkojnë më shumë nga liderët e tyre, si dhe mund ta ndërrojnë votën e tyre po aq shpesh sa votuesit urbanë. Shumica e kosovarëve janë qartas të zhgënjyer me procesin e votimit, ndërsa ne presim që qytetarët e rëndomtë do t'i raportojnë shkeljet më shpesh, që mund ta ulë nevojën për vëzhgim masiv në të cilin jemi mësuar të mbështetemi tej mase.

Liderët do të vlerësohen më shumë për performancën e tyre gjersa politika të bëhet më pak personale dhe radioaktive. Hapësira më e madhe për votuesit e rinj mbetet në radhët e

grave të cilat votojnë më pak dhe interesat e të cilave nuk po mbështettn nga asnjë grup. Partia që mobilizon gratë mund të dalë fituese në zgjedhjet e 3 nëntorit.

Lista e publikimeve

Zgjedhjet:

#1: Instituti Demokraci për Zhvillim. Shtator 2011. Zbërthimi i trendeve zgjedhore 200-2010

#2: Instituti Demokraci për Zhvillim. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si ta rikthejmë besimin në zgjedhje?

#3: Leon Malazogu, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën

#4: Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi, Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?

Marrëdhëniet Ndëretnike:

#1: Leon Malazogu dhe Vladimir Todorčić, Nëntor 2011. Dialogu Beograd – Prishtinë: Nevojitet transformim i interesit vetanak

#2 Leon Malazogu, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë

#3 Leon Malazogu dhe Florian Bieber. Shtator 2012. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen

#4: Leon Malazogu dhe Alex Grigorev me kontribut nga Drilon Gashi. Shtator 2012. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen PER-K/ D4D Institute.

#5: Leon Malazogu dhe Alex Grigorev. Shtator 2013. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv – Si ti qasemi veriut të Kosovës? PER-K/D4D Institute

Interesi publik:

#1: Dardan Sejdiu dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. ‘Taksa’ e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?

#2: Drilon Gashi dhe Shoghi Emerson. Janar 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë

#3: Visar Sutaj dhe Leon Malazogu. Janar 2013. Le të ngritet shoqëria civile e vërtetë! Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik.

Memorandumet:

#1: D4D. Nëntor 2012. Memorandum reagues. Nr.1. Reagim i tepruar i policisë

#2. D4D. Dhjetor 2012. Memorandum reagues. Nr.2. Modeli i dy Gjermanive.

#3: D4D. Korrik 2013. Memorandumi reagues. Nr.3. Kritere të qarta për komuna të reja

Indikatorët:

#1: D4D. Nëntor 2010. Para dhe Pas-Performanca e bazuar në indikatorë: Vlerësimi vjetor 2010.

#2: D4D. Shteti në Pasqyrë: Indikatorët e Bazuar në Performancë

D4D në publikime tjera:

SüdstEuropa Mitteilungen. 05-06 2012.



Leon Malazogu dhe Florian Bieber.

Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen.

Forumi 2015. Seria e analizave “Çka shkoi ters?”

Top problemet zgjedhore. Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor

Seria: Zgjedhjet



Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

324 (496.51)(048)

Interpretimi i besimit : përceptimi e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes / [Studimi është përgatitur nga Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi]. – Prishtinë : Instituti Demokraci për zhvillim, 2013. – 80 f. : ilustr. ; 21 cm.

1.Malazogu, Leon 2. Kllokoqi, Selatin

ISBN 978-9951-608-22-0

Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010 me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Themeluesit e D4D besojnë se demokracia është mjet dhe qëllim për zhvillim dhe janë të përkushtuar që të hulumtojnë dhe të përfshijnë një komunitet më të gjerë drejt këtij qëllimi.

Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

ISBN 978-9951-608-22-0



9 789951 608220